

Kompania “ Esha Energy” L.L.C  
Adresa: Rr. Fehmi Agani, Nr.25/8  
Prishtinë



## RAPORT

I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PARKUN E  
ENERGJISË DIELLORE 9 MW NË LOKALITETIN VËRNICË– „ESHA  
ENERGY 2“, KOMUNA E VUSHTRRISË

**Korrik, 2024**

Kompania “ Esha Energy” L.L.C, për kryerjen e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Ndërtimin e Parkut të Energjisë Diellore “ESHA ENERGY 2” me kapacitet 9MW në lokalitetin Vërnice, Komuna e Vushtrisë, autorizon Prof.Dr. Islam Fejza, Person fizik i Licencuar për hartimin e Raporteve të VNM-së

Investitori Kompania “ Esha Energy” L.L.C

Pronar: Arten Bajrush

---

Vv

Hartues i Raportit të VNM-së:

Prof.Dr. Islam Fejza, Person fizik i Licencuar për hartimin e Raporteve të VNM-së,  
Licenca nr. 5/19



## Përmbajtja

1.0 Hyrje	5
2.0 Baza ligjore për hartimin e raportit	6
2.1 Rregullativa ligjore	6
2.2. Metodologjia e punës	8
3.0 Përshkrimi i Lokacionit dhe Mjedisit	9
3.1. Potencialet ekzistuese	10
3.2. Pozita gjeografike e lokacionit	10
3.3. Popullata dhe Vendbanimet	14
3.4. Infrastruktura ekzistuese	14
3.5. Kushtet klimatike	14
3.6. Gjendja Hidrologjike	15
3.7. Flora dhe Fauna	17
3.8. Ndërtimi gjeologjik i lokacionit	17
Triasiku i mesëm ( T <sub>2</sub> )	17
Sedimentet flishore ( <sub>3,4</sub> <sup>2</sup> K <sub>2</sub> <sup>3</sup> )	18
DEPOZITIMET E PLIOCENIT(PI <sup>2</sup> <sub>1</sub> )	18
TEKTONIKA	19
3.9. Karakteristikat sizmike	20
3.10. Efektet vizuale ( peizazhi)	21
3.11. Ajri	21
3.12. Uji	21
3.13. Zhurma	21
3.14. Natyra dhe biodiversiteti	22
4.0. Përshkrimi i Parkut të Energjisë Diellore (Solare)	22
5.0. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis nga realizimi i projektit	33
5.1. Ndikimet në mjedis gjatë fazes së ndërtimit	33
5.1.1. Ndikimet në Tokë	34
5.1.2. Ndikimet nga gjenerimi i mbeturinave	34
5.1.3. Ndikimet në Ajër	35
5.1.4. Ndikimet në Ujë	35
5.1.5. Ndikimet nga Zhurma	36
5.1.6. Ndikimet në Florë dhe Faunë	36

5. 2. Ndikimet në mjedis gjatë fazës së operimit	37
5. 2. 1. Ndikimet nga pajisjet e instaluara	37
5. 2. 2. Refletkimi i dritës	38
5. 2. 3. Pasqyrimi	38
5. 2. 4. Peizazhi	38
5. 2. 5. Fushat elektrike dhe magnetike	39
5. 2. 6. Efektet vizuale	39
5. 2. 7. Ndikimet ne Faunë	40
5. 3. Ndikimet në mjedis pas ndërprerjes së shfrytëzimit	40
6.0. Marrja e Masave për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Ndikimeve	40
6.1. Ndërmarrja e masave gjatë fazës së ndërtimit	41
6.1.1. Ndërmarrja e masave për mbrojtje nga zhurma dhe gazërat	41
6.1.2. Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e tokës dhe ujërave	41
6.1.3. Masat e përkujdesjes për materialin tepricë	42
6.2. Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë operimit	42
6.2.1. Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e llojeve bimore dhe shtazore	43
6.2.2. Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e tokës dhe ujit	43
6.2.3. Ndërmarrja e masave për menaxhimin e mbeturinave	43
6.2.4. Ndërmarrja e masave për zbutjen e ndikimit vizual	44
6.2.5. Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e zogjëve	44
6.3. Masat e mbrojtjes së mjedisit pas ndërprerjes së projektit	45
7. 0 Plani i Menazhimit dhe Monitorimit të Mjedisit	46
<b>7.1 Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM)</b>	46
<b>7.2 Plani i Monitorimit të Mjedisit</b>	1
8.0 KONSULTIMI ME PUBLIKUN	1
10.0 Përfundim	2

## 1.0 Hyrje

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e Parkut të Energjisë Diellore(Solare) prej 9 MW, në lokalitetin Vërnice – “ESHA ENERGY 2”, Z.K Vërnice me nr. te parceles P-70202015-00644-0 ne vendin e quajtur Zabran/Utrina, Komuna e Vushtrrisë, është punuar në bazë të kërkesës së Arten Bajrushit, përfaqësues i Kompanisë **Esha Energy L.L.C**. Raporti në fjalë paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor e pastaj lejeve tjera të nevojshme për ndërtimin e Parkut të Energjisë Diellore me qëllim që të analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë, duke i parashtruar dhe ndërmarrë masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokalitetin ku do të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore.

Ndërtimi i Parkut të Energjisë me anë të paneleve Diellore është në pajtueshmëri të plotë me strategjinë e Republikës së Kosovës për shfrytëzimin e burimeve alternative të energjisë, pasi që Kosova është në procesin e harmonizimit të legjislacionit me atë të BE-së në fushën e mbrojtjes së klimës si dhe në fushën e shfrytëzimit efikas të energjisë dhe promovimit të energjisë alternative.

**Qëllimi i studimit** - Parku i Energjisë Diellore do të ndërtohet me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike nga energjia diellore duke bërë shndërrimin e energjisë Diellore në energji elektrike përmes celulave solare. Energjia e prodhuar përmes paneleve Diellore shndërrohet në energji alternative përmes inverterëve e cila pastaj përmes transformatorit bartet në rrjetin e energjisë elektrike.

Përmes VNM-së do të analizohen karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin ku do të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat tjera mjedisore të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër.

Gjatë hartimit të Raportit të VNM-së do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante në mjedis që mund të paraqiten në relacionin e ndërtimit te Parkut të Energjisë Diellore duke mos anashkaluar edhe regjionin e gjerë. Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ky Raport i VNM-së bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për t`u ndërmarrë për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative. Me rastin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të

Ndikimit në Mjedis do të merret për bazë identifikimi i ndikimeve negative në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore, gjatë fazës së kryerjes aktiviteteve prodhuese në Parkun e Energjisë Diellore dhe pas fazës së përfundimit të aktiviteteve prodhuese në Parkun e Energjisë Diellore.

## **2.0 Baza ligjore për hartimin e raportit**

Raporti i VNM-së përfshinë identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti mjedisor gjatë realizimit të ndërtimit dhe funksionimit kontinuel të Parkut të Energjisë Diellore bazuar në :

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin gjerë në kufijtë e lejuar.

### **2.1 Rregullativa ligjore**

a) Dokumentacioni normativ

Ne lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM-së, është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së .

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181 ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative, të përcaktoj rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private, garantimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe të hapur vendimmarrjeje përmes përcaktimit të rregullave dhe procedurave administrative gjatë procesit të vendimmarrjes për pajisje me pëlqim mjedisor.

Ligjet me të rëndësishme të aplikuara për hartimin raportit të VNM-së për projektin për ndërtimin e Parkut të Energjisë Diellore janë si më poshtë:

- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes Nr .03 / L-043

- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligji për Energjinë Nr. 05/L- 081
- Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084
- Ligji për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina nr.08/L-071 per ndryshimindhe plotesimin e ligjit me Nr. 04/L-060
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji per ndryshimin dhe plotesimine Ligjit nr.2003/3 per pyjet e Kosoves nr. 03/L-153
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqorë.
- Udhëzimi Administrativ(qrk) Nr. 03/2021 per menaxhimin e mbeturinave te rrezikshme.
- Udhëzimi Administrativ(qrk) Nr. 08/2017 per menaxhimin e deponive te mbeturinave
- Udhëzimi Administrativ(qrk) Nr.07/2021 per rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajer nga burimet e palevizshme te ndotjesb) dokumentacioni teknik
- Udhëzimi administrativ(ME) Nr. 02/2023 per caktimin e energjise elektrike nga burimet e ripertitshme te energjise.

b) dokumentacioni teknik

- Projekti ideor për ndërtimin e Parkut të Energjisë diellore
- Çertifikata e biznesit,
- Çertifikatat mbi të drejtat e pronës së paluajtshme ,

- Kopja e planit të ngastrave,
- Plani i rilevimit
- Pëlqimi Komunal
- Kontrata për shfrytëzimin e ngastres

Krahas parashikimeve themelore nga rregullativat ligjore të cekura më lartë, për nevoja të hartimit të raportit të VNM-së, janë shfrytëzuar edhe rregullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi. Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshënuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis siç është direktiva 2014/52/EU e PE dhe Keshillit e dt.16Prill 2014 e cila ndryshon Direktiven 2011/92/EU mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të caktuara publike dhe private

## **2.2. Metodologjia e punës**

Hartimi i Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis është bazuar në legjislacionin vendor dhe ndërkombtar, përveç eksperiencës profesionale dhe konsultimeve që janë bërë me ekspertët që do të udhëheqin procesin, për ndërtimin e Parkut të Energjisë Diellore prej 9 MW “ESHA ENERGY 2”, gjatë hartimit janë marrë parasysh edhe përvojat dhe praktikat më të mira nga vendet e BE-së. Gjithashtu, janë shfrytëzuar materialet dhe dokumentet si në vijim:

- Plani Zhvillimor i Komunës së Vushtrrisë,
  - Plani Lokal për Veprim në Mjedis i Komunës së Vushtrrisë
- Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për ndërtimin e Parkut të Energjisë Diellore, zhvillohet në disa faza:

Informatat themelore që nënkupton identifikimet siç janë :

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis.
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku planifikohet të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,



- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c) Analiza e rrezikimit të

- popullatës
- vlerave materiale
- vlerave natyrore

d) Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kuantifikimit dhe vlerësimin të gjendjes ekzistuese.

Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që ka të bëjë me potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

### **3.0 Përshkrimi i Lokacionit dhe Mjedisit**

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit.

Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë terren . Për t`u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për t`u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike. Rëndësia e veçantë e këtij projekti është, pos tjerash, në zhvillimin e ekonomisë komunale të Vushtrrisë. Një ndër prioritetet në realizimin e këtij projekti është krijimi i vendeve të reja të punës dhe furnizimi me rrymë elektrike i komunës së Vushtrrisë.

### **3.1. Potencialet ekzistuese**

Njëri nga elementet kyç të hulumtimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit është potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të lokacionit ku planifikohet të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre. Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjellta të faktorëve natyror siç janë: toka, uji, ajri, relievi, flora dhe fauna. Secili nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksione të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë në analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit.



### **3.2. Pozita gjeografike e lokacionit**


Parku i Energjisë Diellore (Solare) - "ESHA ENERGY 2", është planifikuar të ndërtohet në lokalitetin Vërnica, Z.K Vërnice, Komuna e Vushtrrisë.

Karakteristikë e përgjithshme e pozitës së Vushtrrisë është se; ndodhet në verilindje të Kosovës, me një sipërfaqe totale prej 345 km<sup>2</sup> me një dendësi të popullësisë prej 202 banaor në km<sup>2</sup> me gjithesej 67 fshatra. Vushtrria është e rrethuar nga Mitrovica në veri, Podujevo në lindje, Obiliqi në jug, Drenasi në jug-perëndim dhe Skenderajin në perëndim. Komuna e Vushtrrisë merr afërsisht 3.2% të territorit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës. Vushtrria ka një pozicion gjeografik shumë të favorshëm sepse shtrihet në pjesën veriore të "Rrafshi i Kosovës". Autostrada Prishtinë – Mitrovicë kalon nëpër Vushtrri, dhe lidh rajonin verior të Kosovës me pjesën lindore dhe qendrore të vendit. Nëpër territorin e Vushtrrisë kalon edhe sistemi i ujitjes i Ibër –Lepencit.

Parku i Energjisë Diellore, është planifikuar të ndërtohet në Zonën Zona Kadastrale Vërnice me nr. te parceles P-70202015-00644-0 ne vendin e quajtur Zabran/Utrina, numri i lëndës të Çertifikatës 18-793/24, datë 22.03.2024, Komuna e Vushtrrisë. Ngastra kadastrale e lartëcekur është në pronësi të Z. Vesel Fejzullahu. Pronësia e ngastrës dëshmohet me anë të Çertifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme. Z. Vesel Fejzullahu këtë ngaster ja ka dhenë në shfrytëzim per kohëzgjatje prej 30 vitesh Z. Bekim Shyti shih kontraten e noterizuar LRP/Nr.Rend. 4488/2024. Pastaj Z. Bekim Shyti ka lidhë Kontratë të

nënqirasë me Kompaninë "Esha Energy" L.L.C për shfrytëzimin e kësaj ngastre per ndertimin e Parkut të Energjisë Djellore për një periudhë 30 vjeçare(shih Kontraten e vertetuar te Noteri LRP/Nr.Rend.4490/2023. Lokacioni ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore ndodhet i larguar nga objektet e banimit në largësi mbi 50m. Lokacioni ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore, pasqyrohet në hartën topografike të më poshtme.





Ortofoto – Lokacioni Vërnice

Sipërfaqja  $S = 101219 \text{ m}^2$  e pjesës së ngastres kadastrale P-70202015-00644-0, Komuna e Vushtrrisë, në të cilat është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore, gjendet e përcaktuar brenda koordinatave:

Nr.parceles 644-0						
Nr	Y	X		Nr	Y	X
1	7496613.124	4737464.283		37	7496258.163	4737175.75
2	7496610.103	4737450.364		38	7496258.684	4737185.449
3	7496607.973	4737440.074		39	7496248.894	4737191.94
4	7496596.042	4737407.116		40	7496243.994	4737192.78
5	7496579.291	4737374.217		41	7496247.115	4737209.569
6	7496568.07	4737349.979		42	7496268.905	4737214.578
7	7496535.219	4737298.982		43	7496269.115	4737219.588
8	7496491.216	4737202.207		44	7496256.455	4737221.808
9	7496480.576	4737176.208		45	7496271.265	4737238.517
10	7496449.073	4737090.622		46	7496260.646	4737240.818
11	7496392.17	4736980.029		47	7496249.177	4737260.948
12	7496356.048	4736911.802		48	7496244.688	4737274.407
13	7496319.336	4736829.257		49	7496231.129	4737288.488
14	7496206.772	4736884.271		50	7496247.688	4737288.247
15	7496215.323	4736907.74		51	7496260.208	4737276.386
16	7496216.574	4736925.649		52	7496266.437	4737258.827
17	7496210.735	4736944.429		53	7496305.375	4737255.825
18	7496220.845	4736948.808		54	7496361.962	4737241.362
19	7496231.024	4736947.218		55	7496373.642	4737241.042
20	7496231.964	4736951.807		56	7496384.512	4737246.481
21	7496229.045	4736957.957		57	7496420.872	4737276.738
22	7496235.295	4736970.707		58	7496430.772	4737287.557
23	7496236.336	4736999.086		59	7496447.453	4737310.136
24	7496230.917	4737019.946		60	7496457.983	4737324.355
25	7496223.748	4737031.856		61	7496469.133	4737346.194
26	7496234.069	4737052.194		62	7496477.045	4737385.222
27	7496241.369	4737062.424		63	7496493.764	4737378.492
28	7496241.72	4737081.843		64	7496505.234	4737393.411
29	7496244.36	4737095.223		65	7496508.265	4737419.77
30	7496248.77	4737106.042		66	7496506.496	4737436.429
31	7496259.411	4737116.371		67	7496488.888	4737470.309
32	7496253.471	4737125.821		68	7496483.679	4737492.559
33	7496251.592	4737133.861		69	7496489.572	4737551.557
34	7496247.222	4737143.871		70	7496537.978	4737509.655
35	7496246.693	4737157.491		71	7496594.044	4737468.174
36	7496254.203	4737163.65				

Ngastrat janë të përshtatshme për ndërtimin e Parkut të energjisë diellore (centralit të energjisë nga dielli) duke u bazuar në pozitën gjeografike të lokacionit, i cili mundëson afat kohor të rrezatimit më të gjatë dhe është në përputhshmëri me kërkesat e Kompanisë.

### ***3.3. Popullata dhe Vendbanimet***

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundëshme në mjedis, paraqet popullata dhe demografia e sajë. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar. Në afërsi të lokacionit ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore nuk ndodhen objektet të banimit. Objektet e banimit ndodhen në largësi mbi 50m. Prandaj, në pikëpamje mjedisore, Parku i Energjisë Diellore nuk do të ketë ndonjë ndikim relevant në popullatë, por banorët përreth do të kenë vetëm dobi sepse një pjesë e komunitetit do të punësohen në Kompaninë Esha Energy për kryerjen e aktiviteteve gjatë ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore dhe aktiviteteve për prodhimin e energjisë elektrike gjegjësisht për mirëmbajtjen e pajisjeve të Parkut të Energjisë Diellore.

### ***3.4. Infrastruktura ekzistuese***

Komuna e Vushtrrisë ka lidhje të mira të komunikacionit rrugor me të gjitha komunat që e rrethojnë, si dhe me Kryeqytetin e Kosovës Prishtinën që e afrojnë edhe me pjeset tjera të Kosovës dhe këtë përmes rrugëve të asfaltuara. Gjithashtu, në afërsi kalon edhe hekurudha me pikë stacionimi në qytetin e Vushtrrisë. Sa i përket infrastrukturës ekzistuese, infrastruktura rrugore është e ndërtuar, në afërsi të lokacionit ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore kalon rruga Obiliq – Vushtri - Mitrovicë e cila e lidhë Vushtrrin me të gjitha rruget magjistrale.

### ***3.5. Kushtet klimatike***

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë kontinentale.

Territori ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë Djellore Temperatura mesatare e janarit është - 0.9 shkallë, ndërsa ajo e korrikut + 21.5 gradë. Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen përafërsisht me klimë të njëjtë.

Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal.

Temperatura mesatare sillet prej 9.9°C gjerë në 10,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 10,3°C.

Temperaturat më të larta në vitet e hulumtuara (2002-2008) janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C.

Temperaturat më të ulta kanë qenë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore për vitet e hulumtuara janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej (-1,7)-(-3,4°C).

Regjimi i reshjeve ne komunën e Vushtrrisë ka karakterin e klimës aride.

Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 499 mm deri ne 675 mm.

Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 76.8%.

Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2 %.

Erërat për shkak të konfiguracionit e posaçërisht pozitës gjeografike më së shumti janë të përfaqësuar erërat veriore.

Me intensitet më të madhe të shpejtësisë paraqiten erërat veriore, veri perëndimore si dhe erërat perëndimore, kurse ato jugore janë me intensitet më të vogël. Në komunën e Vushtrrisë erërat më të shpeshta janë ato veriore me 225‰ dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 226‰, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 3.2 m/sek.

### **3.6. Gjendja Hidrologjike**

Karakteristikat hidrogjeologjike të lokacionit janë të thjeshta. Morfologjia, ndërtimi gjeologjik, tektonika janë faktorët dominantë të cilët definojnë lëvizjen e ujërave sipërfaqësore dhe ato nëntokësore.

Në afërsi të lokacionit ku planifikohet të ndërtohet Parku i Energjisë Djellore burime natyrore të ujit nuk ekzistojnë, ne afërsi kalon ujërrjedha e Vernices e cila derdhet ne lumin Sitnicë dhe kanali i ujitjes se Iber Lepencit. Ujërat sipërfaqësore të cilat krijohen gjatë të reshurave atmosferike drenohen në ujërrjedhë dhe pastaj

gravitojnë në drejtim të lumit të Sitnicës, që njëherit paraqet edhe ujëmbledhësin kryesor në këtë rajon i cili është në largësi të pa përfillshme nga lokacioni ku planifikohet të ndërtohet Parku i Energjisë Djellore. Qytetin e Vushtrrisë e përshkojnë Lumi Sitnica, si lumi më i madh, që përshkon tejpërtej teritorin e Komunës, ndërsa dy lumenj më të vegjël: Tërstena dhe Studimja, kalojnë nëpër qytetin e Vushtrrisë.

Komuna e Vushtrrisë, në përgjithësi ka pasuri të mjaftueshme ujërash. Lumi kryesorë është Lumi Sitnica i cili shërben si recipient i të gjithë lumenjve të vegjël apo rrjedhjeve në formë të përroskave që janë aktiv sipas sezoneve apo të reshurave atmosferike. Pastaj ekzistojnë edhe dy lumenj më të vegjël Tërstena dhe Studimja të cilët derdhen në lumin Sitnica. Sasia më e madhe e ujërave në këtë lumë është në muajin shkurt dhe mars, kurse sasia më e vogël është në muajin gusht dhe shtator. Lumi Sitnica rrjedh nëpër terren fushor me një pjerrtësi mesatare 0,7 m/km. Një dukuri mjaft e dëmshme është ndotja e vazhdueshme e këtij lumi posaçërisht nga kompleksi i termoelektranës. Sitnica është degë kryesore e Ibrit. Ky lumë dallohet jo vetëm për kah madhësia e pellgut (2.861 km katrorë), por edhe me prurje vjetore (16, 6 m<sup>3</sup> në sec.) Sitnica formohet nga rrjedha Matica me Sazlinë dhe lumin e Shtimes. Këto rrjedha afër fshatit Robovc bashkohen, duke formuar lumin Sitnicë, nga këtu e deri në vëndderdhje në lumin Ibër, afër Mitrovicës kalon gjatësinë prej 90 km. Veçori e këtij lumi është pjerrtësia e vogël, pra karakterizohet si lumë fushor. Ujërat sipërfaqësore paraqiten vetëm gjatë të reshurave atmosferike, kurse thellësitë e ujërave nëntokësore në këtë lokalitet nuk janë të hulumtuara, prandaj nuk dihet saksisht thellësia dhe sasia e ujërave nëntokësore.

Ndërtimi i Parkut të Energjisë Djellore nuk do të ndikojë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore si dhe nëntokësore pasi që investitori duhet të ketë vëndin e veçantë për precipitimin e vajrave të makinave punuese dhe hedhjen mbeturinave hekurore të shkatërruara.



### **3.7. Flora dhe Fauna**

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore.

Mirëpo, në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethinë të zonës ku planifikohet të realizohet projekti kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, kulturat periodike bujqësore si dhe bimësi drusore si shelgu, plepi, etj.

Duke marrë parasysh karakteristikat e gjendjes ekzistuese mund të konstatohet se në lokacionin e këtij regjioni nuk ka potenciale të shprehura të vegjetacionit të cilat mund të rrezikohen me ndërtimin dhe funksionimin e Parkut të Energjisë Djellore. Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit të rajonit, e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, në këtë zonë jetojnë gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, derri i egër, iriqi etj.

Prej brejtësve jetojnë - mijtë, prej zvarranikëve - gjarpri i zakonshëm, bolla, breshkat e tokës zhapini i gjelbër, insektet krahëfortë, krahëlusporë, mizat etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, çafkat, bilbilat, thëllënëza e fushës, sorra , shqiponja, etj.

### **3.8. Ndërtimi gjeologjik i lokacionit**

Rajoni i gjërë përreth zonës ku do ndërtohet Parku i Energjisë Djellore përbëhet nga njësitë e ndryshme litostratigrafike të cilat fillojnë me sedimentet e Triasit të mesëm, sedimentet flishore të Senonianit të sipërm, brekçiet heterogjene të Miocenit dhe sedimentet pliocenike të Pontianit të sipërm.

#### ***Triasiku i mesëm ( T<sub>2</sub> )***

Në vargmalet e Qyqavicës është e veçuar seria metamorfike e Triasit të mesëm me ndërfutje të kuarciteve, gëlqerorëve kristalorë dhe vullkaniteve të metamorfizuara. Triasi i mesëm në Qyqavicë dhe pjesët e saj periferike përfaqësohet nga: rreshpet argjilore, filitet, rrallë rreshpe klorit –sericitike, metaranorë, kuarcite, gëlqerorë kristalorë të silifikuar, metadiabaze dhe metaspilite.

Në bazë të faunës së gjetur në gëlqerorët kristalorë është përcaktuar edhe moshja e këtyre sedimenteve si Trias i mesëm. Nga shkëmbinjtë magmatikë takohen: diabazet, spilitet derisa gabrot janë shumë të rralla. Diabazet dhe spilitet lajmërohen në formë të daljeve të vogla apo të mëdha brenda sedimenteve argjilore –ranorike të triasit të mesëm.

### ***Sedimentet flishore ( $_{3,4}^2K_2^3$ )***

Facia flishore e Senonianit të sipërm në këtë rajon është e kushtëzuar nga thyerjet e thella tektonike të zonës së Vardarit pas Kretakut të sipërm ( Plansheti i Mitrovicës  $K_{34-42}$ , Sh 1: 100000).

Marrë në tërësi, facia flishore e Senonianit të sipërm veçohet me prezencën e alevroliteve, argjiliteve dhe ranorëve të cilët alternohen në mënyrë ritmike me prezencë të Olistoliteve. Olistolitët përbëhen nga serpentinitet, shkëmbinjtë e formacionit vullkanogjeno –sedimentar, gëlqerorët e Turonianit dhe gëlqerorët mergelor pllakorë të facies paraflishore.

### **Brekçiet heterogjene(M)**

Në mallet e Qyqavicës dhe në pjesët periferike të tyre takohen disa dalje të brekçieve heterogjene të izoluara të Miocenit të cilat shtrihen në mënyrë transgresive mbi sedimentet e Triasikut, serpentinitet apo sedimentet e melanzhit të Senonianit. Në ndërtimin e tyre marrin pjesë: rreshtet kristalore, serpentinitet, ranorët dhe gëlqerorët me mbetje faunistike të Senonianit. Madhësia e fragmenteve sillet nga disa centimetra deri në gjysëm metre. Masa cementuese është silicore apo karbonatike. Me gjasë brekçiet janë formuar me cementimin e materialit të shpatit gjatë Miocenit atëherë kur Liqeni me të madhe ka vërshuar Qyqavicën.

### ***DEPOZITIMET E PLIOCENIT(P $P_1^2$ )***

Depozitimet e Pliocenit – kati Pontian i sipërm, përfaqësohen nga argjila me ngjyrë hiri të cilat vende – vende janë kthyer në argjila të pjekura të ashtuquajtura “Brand”. Këto argjila përmbajnë shumë mbetje të mollusqeve dhe Ostrakodave të ujërave të ëmbla( Congeria ornithopsis, Kosovia ornatu, Viviparus viquesneli etj)

Në mes të fshatrave Siboc dhe Zhilivodë argjilat mergelore ngjyrë hiri të horizontit të sipërm(tavanore) kanë arritë në nivel të njejtë me metamorfitet e triasit të

mesëm – sipër,( Dislokacioni i Qyqavicës). Në pjesë më të thella lajmërohen edhe shfaqje qymyrore të cilat tregojnë se kemi të bëjmë me një regjim sedimentimi të fazës liqenore

## TEKTONIKA

Në këndvështrimin e zonimit tektonik, rajoni i përket zonës së Vardarit. Ky territor pozicionohet ndërmjet zonës së Korab - Pelagonisë në Jug, e studiuar në detaje nga Most (2003) dhe tërësisë metamorfike Lin (Bosnje) në veri që është vazhdimi i Vardarit. Tërësia e fundit është studiuar në detaje lidhur me stadet e deformimit, moshën e tyre, si dhe kinematikën e levizjes së mbulesës së Vardarit (Iliç etj.2004 dhe Iliç dhe Pesiq 2007). Duke ballafaquar rezultatet e këtyre autorëve lidhur me stadet e deformimit që ata kanë evidentuar në këtë rajon, ne mund të japim vetëm supozime, sidomos për moshën e deformimeve.

Most (2003) veçon:

- një stad deformimi  $D_1$  (afërsisht 150 mv) në kushte të facies të shisteve blu (12.5 Kbar), ruajtur në mermere.
- një stad deformimi  $D_2$  (148-130 Mv, pra J2-K1), në temperaturë maksimumi  $\leq 650^\circ$  dhe presion minimum ndërmjet 6-10 kbar. Të dhënat strukturore dhe kinematike tregojnë një drejtim transporti drejt VL të pjesëve të sipërme.
- një stad deformimi  $D_3$  (110-90 Mv, pra K2), në kushte metamorfike të facies shisteve jeshile të gradës mesatare. Zona pelagoniane lindore është prekur nga ky metamorfizem, ndërsa tërësia Almopias (Vardari) është mbuluar nga një metamorfizem penetrues (deformim plastik i vazhduar). Të dhënat strukturore dhe kinematike tregojnë një drejtim transporti drejt JP të pjesëve të sipërme.
- një stad deformimi  $D_4$  (70-80 Mv, K2k5 ose Kampanian), në Korab-Pelagoninë perëndimore, është shënuar nga drejtimi i transporti të mbulesës drejt VL, nën kushtet e facies së shisteve jeshile. Ndërsa në Korab – Pelagoninë lindore kemi deformim gjysëm plastik deri thyrës (brittle).

- Levizja drejt perendimit (rreth 65mv, pra në kufirin kretak/paleogjen), ka qenë e shoqeruar nga metamorfizmi i facies së shisteve jeshile të gradës së ulët dhe shënon evenimentin e fundit duktil të shkaktuar nga thyerjet mbihypse të tërësisë Almopias të Zonës Vardar.

### 3.9. Karakteristikat sizmike

Për analiza sizmike janë përdorë hartat e rrezikut sizmik të botuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës (MZHE) – Shërbimi Gjeologjik, Departamenti i Sizmikës.

Mundësia e goditjeve të tërmetit në Vushtrrië, më saktësisht në këtë fushë studimi, të cilat teorikisht si të dhëna të mundshme (nga Raporti Sizmologjik i Kosovës), mund të jenë me intensitet shtatë (MSK-64).



Rajonizimi sizmik i Kosovës

### **3.10. Efektet vizuale ( peizazhi)**

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të përceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin Parku i Energjisë Diellore - mjedisi.

Me këtë rast gjithësesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinergjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive .

Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Parku i Energjisë Diellore në efektet vizuale nuk do të ketë ndikime negative.

### **3.11. Ajri**

Në territorin e komunës së Vushtrrisë deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore.

Nga vet konfiguracioni i terrenit dhe prezenca e florës, dhe mos ekzistimit të objekteve industriale në këte lokacion, mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të lakmueshëm.

### **3.12. Uji**

Kualiteti i ujit të lumit Sitnicë është i nivelit të ulët edhe pse ngastra ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë Djellore nuk ka ndotës potencial. Ndotja e ujit shkaktohet nga ujërat e zeza të cilat shkarkohen nga komuniteti në lumë të pa trajtuara, nga hedhja e mbeturinave nga komuniteti në brigjet e lumenjve dhe në shtretërit e tyre, nga termocentralet e KEK-ut. Ndotja e ujërave vjen edhe nga aktivitetet ilegale të eksploatimit dhe seperimit të rërës dhe zhavorrit që ekzistojnë në këte lokalitet.

### **3.13. Zhurma**

Në lokacionin e analizuar dhe më gjerë nuk kemi ndonjë matje të zhurmës.

Mund të konstatojmë se në lokacionin ku është planifikuar të ndërtohet Parku i Energjisë Djellore nuk kemi zhurmë të përhershme që do të ndikonte në psikikën

dhe koncentrimin e njeriut në rrethinë, pasi që objektet e banimit janë larg mbi 50m.

### **3.14. Natyra dhe biodiversiteti**

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës, nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë teren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi. Në këto lokalitete ekziston një urë e vjetër e gurit e cila është futur në monument të kategorisë arkeologjike. Mirëpo ndërtimi i Parkut të Energjisë diellore është mjaftueshëm larg nga kjo urë e mbrojtur.

## **4.0. Përshkrimi i Parkut të Energjisë Diellore (Solare)**

Projekti për ndërtimin e Parkut të Energjisë Diellore me kapacitet të instaluar 9 MW/h dhe prodhim vjetror 12GWh është përgatitur nga Kompania Esha Energy L.L.C

Kompania Esha Energy L.L.C është themeluar në vitin 2022 me seli në Prishtinë me veprimtari në fushën e energjisë prandaj, ka përgatitur projektin dhe planifikon të ndërtoj Parkun e Energjisë Diellore në vendin e quajtur Vërnica, zona kadastrale Vërnice, Komuna e Vushtrrisë.

Prona/ngastra ku shtrihet projekti, janë prona private kryesisht të pakultivuara nga aspekti bujqësor.

Projekti parashihet të fillojë së ndërtuari gjatë vitit 2024 dhe do të vë Komunën e Vushtrrisë në hartën evropiane të projekteve të tilla ambientale nga energjia e ripërtëritshme diellore.

E tërë energjia e prodhuar do t'ishitet tregut të lirë të energjisë sipas rregullave së përcaktuara paraprakisht nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Gjatë ndërtimit të këtij parku solar do të angazhohen në punë rreth 40 persona kryesisht të profilit teknik (pjesa e elektrikës dhe e ndërtimtarisë).

Kohëzgjatja e punimeve në terren pritet të jetë rreth 6 muaj.

Projekti do të ketë ndikim pozitiv në ekonominë lokale, duke përfshi punësim, taksa, furnizim me energji etj.

Në këtë projekt janë paraparë të instalohen 15072 Module Diellore(panele) të tipit polikristaline – Modeli AIKO-A600-MAH72MW.

Pas matjeve të rrezatimit të diellit me anë të programit PV-GYS është bërë simulimi i prodhimit vjetor nga softveri PV-SYS 6.0 me të cilin garantohej një matje +/- 5% e tolerances.

Në tabelen e më poshtme do e paraqesim prodhimin sipas muajve në MWh

	<b>Muaj</b>	<b>Esha Energy 2, MWh</b>
Prodhimi mujar sipas muajve në MWh	Janar	540
	Shkurt	745
	Mars	1050
	Prill	1188
	Maj	1317
	Qershor	1361
	Korrik	1375
	Gusht	1400
	Shtator	1109
	Tetor	917
	Nentor	584
	Dhjetor	414
		<b>Prodhimi vjetor [MWh]</b>
	<b>Kapaciteti [MWp]</b>	9

### **Përdorimi i pajisjeve moderne;**

Pajisjet e planifikuara dhe që do të përdoren në centralin e prodhimit të rrymes nga dielli në Komunën e Vushtrrisë do të prodhohen enkas për këtë projekt me standarde dhe norma të Bashkimit Evropian.

Sistemi i telekomunikimit do të instalohet tipi Solar - Log i cili mundëson menaxhimin e prishjeve dhe mirëmbajtjen e sistemit Online i kyçur në internet.


Të gjitha pajisjet që do të përdoren në këtë projekt janë produkte të cilësisë së lartë dhe teknologjia më e avancuar në prodhimin e energjisë Diellore në Evropë.

Në vijim do të jepen karakteristikat teknike të pajisjeve që do të ndërtohen në Parkun e Energjisë Diellore (Centralin Solar)

- Madhësia - dimensionet e paneleve janë 2278x1134x30mm

- Madhësia -dimenzionet e kornizës (ramit) ku do të vendosen panelet do të jetë 4x12m. Në një Kornizë do të vendosen 48 panela
- në një ram ( kornizë), do të vendosen 48 panela,
- 314 korniza (rame) –  $314 \times 48 = 15072$  panela(module)
- 72 vargje paralele

Në mes të kornizave bëhet një ndarje 0.3m për shkak të dilatimit.



Ky është një varg me 3 korniza të ndara

- distanca (hapësira) e lirë në mes të kornizave, do te jetë 3.34 metra
- në një ram(kornizë) do të vendosen 10 shtylla, gjithësej 3140 shtylla

Solar PV sistemet janë semikonduktor të cilët e konvertojnë energjinë e diellit drejtpërdrejt në energji elektrike. Ato funksionojnë në formë statike dhe nuk gjenerojnë gazëra apo ndotje të ambientit dhe nuk prodhojnë zhurmë. Ato instalohen në struktura të ndryshme varësishte nga vendi dhe pozita. Prodhimi i energjisë elektrike nga sisteme PV Diellore varet nga pozita e tyre, temperaturat, ndriqimi i diellit si dhe lloji i PV moduleve. Për konvertimin e energjisë nga DC në AC përdoren konvertorë të llojeve të ndryshëm dhe madhësive të ndryshme.

Në figurën në vijim janë paraqitë Modulet PV të fikësuara në Strukturë metalike antikorreze në një kënd  $25^\circ$  në drejtim të Jugut. Llojin e strukturës për fikësimin e PV moduleve dhe materialet e nevojshme që do të përdoren në Parkun e Energjisë Diellore (CentralinSolar) do të zgjedhen nga kompanitë Evropiane.

### Teknologjia e propozuar

Për sistemin 9 MWp më poshtë i gjeni prodhuesit e preferuar bazuar në produktet që i ofrojnë:

<b>Teknologjia</b>	<b>Prodhuesit</b>
Panelet solare	Tier 1
Invertori së bashku me kuadrot DC dhe AC	SMA/SIEMENS
Konstruksioni për montim të paneleve	I galvanizuar thellë
Materiale instaluese (konektorë, kablllo)	Multi-Contact (Zvicërr), kablllo Italiane



## **Panelet fotovoltaike (solare)**

Panelet fotovoltaike e konvertorjnë rrezatimin diellor direkt në elektricitet përgjatë një procesi të pastër dhe pa zhurmë dhe që nuk kërkon pjesë lëvizëse.

Efekti fotovoltaik është efekt gjysmë-përcues ku rënia e rrezatimit diellor në qelizat fotovoltaike gjysmëpërcuese gjeneron lëvizje të elektroneve. Dalja e qelizave solare fotovoltaike paraqet electricitet DC. Një plantacion solar përmban shumë qeliza të lidhura në një modul dhe shumë module që lidhen në varg ndërsa vargjet lidhen në parallel që të prodhohet fuqia e dëshiruar DC.


Për këtë projekt ne kemi propozuar që të përdorim panele, +600 Wp, monokristaline.

Të gjitha panelet janë 100% të ricikuleshme dhe PID free.

Garancioni mekanik i produktit është 12 vite ndërsa për prodhueshmëri vlejné garancionet:


- Për 12 vitet e para garantohet prodhimi me mbi 90% të kapacitetit nominal
- Për 18 vitet e ardhshme garantohet prodhimi me mbi 80% të kapacitetit nominal.

Panelli do të vazhdojë të prodhojë edhe pas 30 viteve por me efijencë më të ulët.



## Harta e rrezatimit diellor për Kontinentin Europian

### Photovoltaic Solar Electricity Potential in European Countries




\* Yearly sum of global irradiation incident on optimally-inclined south-oriented photovoltaic modules  
\*\*Yearly sum of solar electricity generated by optimally-inclined 1kW<sub>e</sub> system with a performance ratio of 0.75

© European Union, 2012  
PVGIS <http://re.jrc.ec.europa.eu/pvgis/>

Authors: Thomas Huld, Irene Pineda-Pascua  
EC - Joint Research Centre  
In collaboration with: CM SAF, [www.cmsaf.eu](http://www.cmsaf.eu)

Legal notice: Neither the European Commission nor any person acting on behalf of the Commission is responsible for the use, which might be made of this publication


## Orientimi i paneleve dhe këndi i azimutit



Orientimi i paneleve duhet të jetë ashtu që paneli të jetë në gjendje që sa më shumë kohë gjatë ditës të absorbojë rrezet e diellit. Në hemisferën veriore, në të cilën gjendet Kosova, panelet duhet të orientohen kah jugu – në azimut.

Këndi i azimutit, figura më poshtë, është devijim i rrafshit të panelit nga jugu; me kënd të rrafshit të panelit të orientuar kah jugu, këndi i azimutit është  $0^\circ$ . Pasi që rrezatimi diellor është më intensiv në mesditë, rrafshi i panelit duhet të orientohet sa më afër që është e mundur nga jugu.


Megjithatë, devijimi nga jugu deri në  $45^\circ$  në juglindje ose jugperëndim është i pranueshëm. Në këtë rast duhet të rritet sipërfaqja e paneleve në mënyrë që të kompensohen humbjet e krijuara nga devijimi nga këndi i azimutit.




### ***Këndi i pjerrtësisë***

Këndi i pjerrtësisë është këndi në mes të rrafshit horizontal dhe të panelit diellor, (shih figurën më poshtë).

Sasia më e madhe e energjisë që absorberi i panelit e merr nga dielli është kur paneli është në kënd të drejtë me rrezet e diellit.




**Pozita e diellit.** Në periudha të ndryshme të vitit veprimi I rrezeve të diellit në tokë bëhet në kënde të ndryshme siç shihet në figurën e mëposhtme.




Pra, zgjedhja e orientimit dhe këndit të pjerrësisë së paneleve diellorë apo moduleve fotovoltaike është çështja më e rëndësishme për të përmirësuar efiçencen e këtyre kolektorëve dhe moduleve.

Orientimi optimal i panelit diellor është ai nga Jugu, për Hemisferën Veriore. Ndërsa, këndi kundrejt rrafshit horizontal për të cilin totali mesatar mujor i rrezatimit diellor është maksimal quhet kënd optimal.

Në figurën **a**, paraqitet gjeometria e panelit diellor me orientim nga jugu. Në figurën **b**, paraqitet orientimi i panelit diellor ne Hemisferën e Veriut.



## Parimi i punës së qelizave fotovoltike



Efekti fotovoltai (PV) është baza e konvertimit të dritës në energji elektrike në qelizat fotovoltike ose diellore. E përshkruar thjesht, efekti PV është si më poshtë: drita, e cila është energji e pastër, hyn në një qelizë PV dhe i jep energji të mjaftueshme disa elektroneve (grimcave atomike të ngarkuara negativisht) për t'i liruar ato. Një pengesë e ndërtuar në potencial në qelizë vepron në këto elektrone për të prodhuar një tension (të ashtuquajturit fotovoltazh), i cili mund të përdoret për të drejtuar një rrymë përmes një qarku.

Qeliza PV është e përbërë nga materiali gjysmëpërçues, i cili kombinon disa tipare të metaleve dhe disa karakteristika të izolatorëve. Kjo e bën atë në mënyrë unike të aftë për të konvertuar dritën në energji elektrike. Kur drita absorbohet nga një gjysmëpërçues, fotonët e dritës mund të transferojnë energjinë e tyre tek elektronet, duke lejuar që elektronet të rrjedhin përmes materialit si rrymë elektrike. Ka një sërë materialesh gjysmëpërçuese të ndryshme të përdorura në qelizat diellore.

Silici është materiali më i zakonshëm që përdoret në qelizat diellore, duke përfaqësuar rreth 90% të moduleve sot. Është gjithashtu materiali i dytë më i bollshëm në Tokë (pas oksigjenit). Qelizat kristalore të silikonit janë bërë nga atome silici të lidhur me njëri-tjetrin për të formuar një grilë kristali. Ky grilë siguron

një strukturë të organizuar që bën konvertimin e dritës në energji elektrike më efikase.

### ***Invertorët***

Invertorët përdoren për të konvertuar rrymën e drejtpërdrejt (DC) të gjeneruar nga modulet fotovoltaike diellore në rrymën alternative të rrymës (AC), e cila përdoret për transmetimin lokal të energjisë elektrike.

Invertorët e avancuar, ose "invertorët e mençur", lejojnë komunikimin me dy drejtime midis invertorit dhe veglës elektrike. Kjo mund të ndihmojë në balancimin e ofertës dhe kërkesës automatikisht ose nëpërmjet komunikimit të largët me operatorët e shërbimeve. Lejimi i shërbimeve që të kenë këtë njohuri (dhe kontrollin e mundshëm) të ofertës dhe kërkesës u lejon atyre të zvogëlojnë shpenzimet, të sigurojnë stabilitetin e rrjetit dhe të zvogëlojnë gjasat e ndërprerjeve të energjisë.

Në mënyrë që të maksimizohet fuqia e furnizuar nga fabrika, gjeneratori duhet të përshtatet me ngarkesën, në mënyrë që pika operative të përputhet gjithmonë me pikën maksimale të fuqisë. Për këtë qëllim, brenda një inverteri përdoret një helikopter i kontrolluar i quajtur Maksimal Power Point Tracker (MPPT); MPPT llogarit menjëherë me çast çiftin e vlerave "tension-aktual" të gjeneratorit në të cilin prodhohet fuqia maksimale në dispozicion.

Për këtë Park të Energjisë Diellore (Centralin Solar) do të përdoren invertoret e prodhuesit Gjerman të cilat kanë garancione 20 vjeçare dhe janë të dëshmuar në tregun European.

Invertorët janë të modelit SMA, Tipi MVPS4000-s2. Ky lloj modeli i invertoreve është i prodhuar për gjenerimin e kapaciteteve të mëdha të prodhimit të energjisë Diellore dhe se ka avantazhin e vet për monitorim dhe mirëmbajtje.




### **Struktura e vendosjes së PV paneleve**

Format PV duhet të jenë të montuara në një strukturë të qëndrueshme që mund të mbështesë grupin dhe të përballojë erën, shiun, breshrin dhe korrozionin gjatë dekadave. Këto struktura anojnë fotot PV në një kënd fiks të përcaktuar nga gjerësia lokale, orientimi i strukturës dhe kërkesat elektrike të ngarkesës. Për të arritur prodhimin më të lartë vjetor të energjisë, modulet në hemisferën veriore drejtohen drejt jugut dhe priren në një kënd të barabartë me gjerësinë lokale. Montimi me xhama aktualisht është metoda më e zakonshme sepse është e fuqishme, e gjithanshme dhe e lehtë për t'u ndërtuar dhe instaluar.

Struktura për fiksime të moduleve është paraparë të ketë 4 (kater) rreshta me PV module në secilin rresht me kënd të pjerrësisë  $25^\circ$  dhe Azimut nga  $0^\circ$ .

Në mënyrë që të përmirësohet redimenti i energjisë dhe të zvogëlohet hijja në pjesë të ndryshme të ditës, distanca në mes strukturave montuese të paneleve përcaktohet të jetë afro 8m. Lartësia minimale nga toka e strukturave montuese planifikohet të jetë 0.80m, por kjo varet nga forma e terrenit (shi fig. e më poshtme)



### **Përdorimi i pajisjeve moderne;**

Pajisjet e planifikuara dhe që do të përdoren në centralin e prodhimit të rrymës nga dielli në lokalitetin e komunes së Vushtrisë do të prodhohen enkas për këtë projekt me standarde dhe norma të Bashkimit Evropian. Pjesa më e madhe e produkteve do të vijnë nga Gjermania, Zvicra etj.

Sistemi i telekomunikimit do të instalohet tipi Solar - Log i cili mundëson menaxhimin e prishjeve dhe mirëmbajtjen e sistemit Online i kyçur në internet.

Të gjitha pajisjet që do të përdoren në këtë projekt janë produkte të cilësisë së lartë dhe teknologjia më e avancuar në prodhimin e energjisë Diellore në Evropë.

### **Përputhja e Projektit me objektivat e Strategjisë së Energjisë në Kosovë**

Projekti në fjalë për ndërtimin e Parkut të Energjisë Diellore (Centralit Solar) gjatë vitit 2024 me 9MW është në përputhje me planin dhe strategjinë e Energjisë në Kosovë. Ky projekt i përmbush të gjitha kërkesat dhe certifikatat e origjinës së prodhimit si dhe mbron ambientin në tërësi.

### **Operacionet dhe Mirëmbajtja**

PV Modulet kanë një jetëgjatësi prej 25 viteve të garantuar. Invertorët nga 10 deri në 20 vite garancion të prodhimit. Kabllot, konektorët dhe pajisjet tjera të



telekomunikimit kanë garancione superiore mbi 25 vite. Krejt kjo ndikon në një kosto shumë të ulët të mirëmbajtesjes.

Nga këto studime delë se lokacioni i përzgjedhur është i përshtatshëm për instalimin e centralit solar prej 9 MW dhe se nuk shihet ndonjë pengesë teknike apo funksionale.

## **5.0. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis nga realizimi i projektit**

Analiza e vlerësimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit si dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të cilat janë si pasojë e aktiviteteve të ndërtimit dhe funksionimit të Parkut të Energjisë Diellore (Centralit të energjisë diellore) të Kompanisë Esha Energy, tregojnë se deri te kuantifikimi i të dhënave mund të vije sipas një analize gjithëpërfshirëse.

Të gjitha ndikimet e mundshme nuk janë të vlerave të njëjta që të bëhet edhe kuantifikimi i tyre. Ndikimet në mjedis mund lajmërohen në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit, prandaj të gjitha ndikimet e mundshme negative në mjedis i klasifikojmë në tri periudha themelore dhe ate:

- Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore
- Gjatë fazës e funksionimit të Parkut të Energjisë Diellore dhe
- Ndikimet e mundshme në mjedis pas përfundimit të funksionimit të Parkut të Energjisë Diellore.

### ***5.1. Ndikimet në mjedis gjatë fazes së ndërtimit***

Gjatë kësaj faze aktivitetet shtrihen në instalimin e pajisjeve ndërtimore dhe punëve tjera deri në përfundimin e ndërtimeve, që zakonisht kalojnë pak sipërfaqen e paraparë për instalimin e panelave solare. Punët kryesore të pritura të kësaj faze kanë të bëjnë me hapjen (gërmimin) e trases dhe shtrimin e rrugëve për çasje të automjeteve transportuese për bartjen të pajisjeve instaluese dhe atyre ndihmëse, mihjen e kanaleve të tokës (0,7 – 1,0 m thellësi) për shtrimin e kablllove, zhvendosjen e dheut për përshtatjen e relievit sipas nevojës, vendosjen e mbajtesve të panellave Diellore, bazamentin e invertorit, trafostacionit. Si

rezultat i këtyre aktiviteteve do të shtohet edhe lëvizja e mjeteve të ndryshme transportuese dhe përdorimi i makinerive të ndryshme për ndërtimin e strukturave të ndryshme në zonën e ndërtimit. Këto aktivitete të kësaj faze do të shkaktojnë zhurmë dhe emisione të gazrave shtesë dhe varësisht nga kushtet e punës, me mundësi të emisioneve të pluhurit. Poashtu, nuk përjashtohen edhe mundësitë e rrjedhave të vajrave nga makineritë dhe gjenerimi i mbeturinave të ndryshme, nëse ato nuk menaxhohen si duhet.

### **5.1.1. Ndikimet në Tokë**

Sipas modelit të përzgjedhur për vendosjen e paneleve Diellore, ndikimet në tokë do të jenë të vogla, pasi që mbajtësit e kornizave të paneleve janë në formë të spiraleve dhe do të futën në thellësi deri 1.40 m. Mbajtëset e paneleve janë nga çeliku i zinguar me mundësi korrozioni zero. Dheu i cili do të largohet në një anë gjatë hapjes së kaneleve dhe vendosjes së kabllave elektrike dhe përcjelljen e tyre deri tek transformatori, do të kthehet prapë në vendin ku ka qënë.

Pra, gjatë fazës së vendosjes të mbajtësëve dhe vendosjes së paneleve Diellore ndikimet në kualitetin e tokës do të jenë minimale.

Sasia e dheut të gërmuar nga punimet e lartëcekura duhet të sigurohet që pas vendosjes së shtyllave të kornizave (rameve) për vendosjen e paneleve, të mbulohet sipërfaqja e degraduar për kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme. Sasia e dheut të mbetur të përdoret për tamponimin e rrugëve që përgatiten apo të vendoset në ato lokacione që vlerësohet se nuk ka ndikime negative në mjedis dhe në marrëveshje me strukturat udhëheqëse lokale.

### **5.1.2. Ndikimet nga gjenerimi i mbeturinave**

Gjatë fazës së ndërtimit gjegjësisht vendosjes të mbajtësve të kornizave dhe paneleve Diellore, sasia e mbeturinave do të jetë e papërfillshme, do të krijohen mbeturina jo të rrezikshme nga materialet ndërtimore, ambalazhimet e ndryshme, mbeturinat komunale që janë si pasojë e punimeve të zhvilluara dhe pranisë së personelit në punishten ndërtimore. Poashtu, gjatë ndërtimit krijohet edhe një sasi e caktuar e mbeturinave të rrezikshme ku gjatë shfrytëzimit të automjeteve transportuese dhe mekanizmave ndërtimore mund të vie deri te derdhjet e

pakontrolluara të derivateve dhe vajrave motorike në tokë e pastaj edhe në ujërat nëntokësore. Këto derdhje mund të bëhen nga mosmirëmbajtja jo e rregullt e automjeteve transportuese dhe mekanizmave ndërtimore apo nga moskujdesi i faktorit njeri.

Hedhja e mbeturinave të krijuara pak kontroll në lokacionin e punishtes do të ketë pasoja negative për mjedisin e lokacionit . Për të gjitha llojet e mbeturinave që krijohen gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore-Centralit të energjisë diellore, duhet të vepohet në pajtueshmëri me Ligjin për Mbeturina Nr. 08/L-071 dhe të gjitha akteve nënligjore të këtij ligji, që do të thotë se mbeturina e llojit të njëjtë grumbullohen dhe transportohen në lokacionet e caktuara të komunës së Vushtrrisë apo diku tjetër ku mund të vendosen këto mbeturina si p.sh në deponitë regjionale.

### **5.1.3. Ndikimet në Ajër**

Në fazën e ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore, deri te ndikimet në ajër mund të vie si pasojë e lëshuarjes së materieve të ndotura në ajër nga automjetet dhe mekanizmat ndërtimore që sipas ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 08/L-025 konsiderohen si burime lëvizëse të emisioneve në ajër.

Në hapësirat përreth lokacionit si ndikim në ajër konsiderohet edhe pluhuri i cili ngritët gjatë punëve ndërtimore, pastrimeve, hapjen e kanaleve, hapjen e bazamenteve, shtruarjet me dhe të platove, rrugëve etj, pastaj lëvizja e automjeteve dhe mekanizmave gjatë punës.

Emisioni i pluhurit gjatë fazës së ndërtimit ndryshon nga dita në ditë që do të thotë se varet nga intensiteti dhe lloji i punëve që zhvillohen. Ndikimet e emisionit të pluhurit janë të kufizuara dhe vlerësohen pa pasoja afatgjate në kualitetin e ajrit.

### **5.1.4. Ndikimet në Ujë**

Sipërfaqja ku do të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore - Centrali i energjisë diellore, paraqet një pjerrtësi të vogël që ka një porozitet të theksuar dhe në rastet e reshjeve atmosferike prania e ndotjeve nga kjo sipërfaqe mund të bartet në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe të shkaktojë aksident ekologjik.

Gjatë ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore, nevojitet të përgatitet një sipërfaqe në formë platoje ku do të vendoset makineria punuese me të gjithë mekanizmat

përcjellës në mënyrë që të pengohet ndonjë sasi e derdhjeve të vajrave apo karburanteve dhe të arrijë në rrjedhjet nëntokësore të ujërave.

Krahasuar me të gjitha llojet e burimeve të energjisë, energjia që përfitohet nga parqet Diellore konsumon më së paku ujë për kW/h krahasuar me të gjitha llojet e energjisë, psh: 1kW/h nga parqet Diellore, shpenzon 0.1 lit, ndërsa nga termocentralet 75 lit per kW/h.

#### **5.1.5. Ndikimet nga Zhurma**

Gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore vie deri te ngritja e përkohshme e zhurmës nga funksionimi i automjeteve transportues dhe mekanizmave ndërtimore.

Si pasojë e lëvizjes së automjetve të rënda ndërtimore në fazën e ndërtimit mund të vie deri te ngritja e zhurmës e cila në lokacionet e punës gjatë orarit të punës (8-18) mund të jetë prej 55- 65 dB, në pajtueshmëri me Ligjin për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 dhe Direktivën 2000/14UE për emisionin e zhurmës nga pajisjet e ndryshme që përdoren jashtë objekteve.

#### **5.1.6. Ndikimet në Florë dhe Faunë**

Gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore mund të vie deri te ndikimet në botën bimore dhe shtazore nga funksionimi i mekanizmave të rëndë, punëve të dheut, bota bimore do të shkatërrohet e cila do të mbillet pas përfundimit të fazës së ndërtimit. Ndikimet negative janë mjaft të shprehura në ato lloje të faunës që jetojnë në tokë, sepse me ndërtimin e rrugëve të kalueshme dhe sipërfaqeve për parkim dhe servisim të automjeteve dhe deponim të materialeve drejtpërdrejt ndikon në zvogëlimin e banimit të tyre.

Supozohet se nga lokacioni ku ndërtohet Parku i Energjisë Diellore të gjitha ato lloje të faunës që pengohen (ndikohen) nga aktivitetet që zhvillohen në punishte do të largohen në periferi të lokacionit dhe pas përfundimit të punimeve një pjesë e tyre gjatë kërkimit të ushqimit apo lëvizjeve të tyre përsëri do të kthehet në këtë lokacion.

Pas fazës së ndërtimit do të ketë rrethoja me tela në punishte ashtu që të gjitha rrugët e migracionit të faunës nëpër lokacionin e Parkut të Energjisë Diellore do të jenë të lira.

Ndërtimi i Parkut të Energjisë Diellore në hapsirat përreth nuk ka ndikim në florë dhe faunë sepse kemi të bëjmë me një energji të pastërt me zero emisione operacionale dhe me ndikime minimale në mjedis, pra panelet Diellore sjellin vetëm dobi për mjedisin.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233 në territorin ku planifikohet të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore nuk kemi ndonjë vlerë natyrore që duhet t'i kushtohet rëndësi gjatë fazës së ndërtimit.

## ***5. 2. Ndikimet në mjedis gjatë fazës së operimit***

### **5. 2. 1. Ndikimet nga pajisjet e instaluara**

Këtu merren parasysh ndikimet e shkaktuara nga vetë prezenca e pajisjeve. Si rezultat i ndërtimit të bazamenteve të pajisjeve, shtrimit të rrugëve, etj. vlerësohet se sipërfaqja e ngjeshur dhe mbuluar e tokës nuk kalon 5% të sipërfaqes së përgjithshme të zënë nga panellat diellore. Në rastin kur si bazament për panella Diellore përdoren shtylla (kuja) të ngulitura në tokë, siç është rasti i këtij projekti, atëherë kjo sipërfaqe nuk kalon 2%. Sipërfaqja e tokës e mbuluar nga panellat Diellore me përjashtim të një sipërfaqe që nuk kalon 6-8%, në përgjithësi përfshihen nga rrezatimi i diellit. Sipërfaqja pra, që mund të mbetet në mënyrë të vazhdueshme nën hije, dhe që është prapë në varshmëri të lartësisë së panelave, është shumë e vogël. Në skajet e paneleve, si rezultat i të reshurave, mund të krijohen kanale të vogla dhe të paraqesin mundësi erozioni të tokës.

Kjo varet shumë nga rënja e terrenit dhe lloji i tokës. Në rastin konkret, kur sipërfaqja është relativisht e rrafshët dhe toka ka përbërje të konsiderueshme.

Sa i përket ndikimeve në botën shtazore nga prezenca e paneleve Diellore, nuk ka studime të hollësishme. Ekzistojnë vlerësime se ndikimet mund të jenë pozitive apo negative, në varshmëri të llojeve të shtazëve.

Edhe pse projektet e ndërtimit gjithmonë shkaktojnë shqetësim të flores dhe faunes ekzistuese, me parqe Diellore, është shansa për të përmirësuar kualitetin e habitatit për lloje të ndryshme të shtazëve dhe bimëve, apo edhe duke krijuar habitate të reja. Nga ana tjetër, sipërfaqet e tokave të punuara njihen me një biodiversitet shumë më të ulët se sa sipërfaqet tjera natyrore, përjashtuar këtu vendet e thata

### **5. 2. 2. Refletkimi i dritës**

Parqet e Energjisë Diellore, përdorin rrezatimin e diellit për prodhimin e energjisë, për këtë arsye transmisioni dhe absorbimi i rrezeve të diellit nga aspekti teknik është duke u forcuar dhe rrezatimi duke u reduktuar. Kjo arrihet duke instaluar shtresa antirefleksuese në celulat Diellore dhe duke vendosur qelqa ballorë special. Megjithatë, vlerësohet se deri në 5% e dritës mund të reflektohet. Për shkak të këtij reflektimi, modulet Diellore në një mes natyrore me vegjetacion, paraqiten si objekte me te ndriqara. Gjatë rënjes së thellë të diellit (këndi i rënjes nën 40%), paraqiten refleksionet në mënyrë të shtuar, mirëpo ky reflektim kryesisht shpërndahet me ndihmën e qelqeve ballore. Në këtë rast reflektimet paraqiten në pjesën perendimore dhe lindore të panelave. Mirëpo, ky refleksion i shpërdarë vlerësohet të humb efektin vetëm në disa dm distancë nga panellat, dhe më këtë nuk paraqet ndonjë ndikim në mirëqenjen e njerëzve (në këtë rast banuesve më të afërt).

### **5. 2. 3. Pasqyrimi**

Sipërfaqet pasyruese reflektojnë objektet (fotografinë) përreth. Strukturat e habitateve të reflektuara mund të mashtrojnë shpezët (p.sh. zogjët) duke ju krijuar imazhet e hapësirave jetësore dhe në këtë mënyrë duke joshur dhe paraqitur rrezik për ato.

Kjo para së gjithash mund të ndodhë në lokacionet me prezencë dhe mundësi të reflektimit të drunjëve. Mirëpo, ekzistojnë edhe studime të cilat tregojnë se për një grup zogjësh panelat diellore mund të ndikojnë pozitivisht, duke ju ofruar strehim dhe biotope ushqimi kryesisht në sezonin e dimrit.

### **5. 2. 4. Peizazhi**

Lokacioni ku planifikohet të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore, është lokacion me një pejsazh heterogjen në cilin nuk ka vegjetacion të lartë që mund të pranojë një përbamje të re me ndërtimin e Parkut të Energjisë Diellore, pa ndërrime të theksuara. Në fokus do të jetë mjaftë atraktive ndërtimi i centralit të energjisë diellore mbi vegjetacionin e pjesës kodrinore. Sipas të gjitha vlerësimeve paraprake që i përkasin ndikimeve vizuale janë pozitive për lokacionin ku planifikohet të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore.

### **5. 2. 5. Fushat elektrike dhe magnetike**

Si prodhues të mundshëm të rrezatimeve mund të vijmë në pyetje: panelat Diellore, sistemi i kablllove, Invertori dhe transformatori. Fusha magnetike e krijuar nga rryma njëkahore( e prodhuar nga celulat solare), janë aq të ulëta sa në një distancë prej vetëm 50 cm nga panelet janë të barabarta me fushen magnetike natyrore. Poashtu, edhe kablloprodhojnë fusha magnetike dhe elektrike të niveleve shumë të ulëta dhe vetëm në zonën e ngushtë mes kablllove dhe që vlerësohen si jo problematike.

Invertorët prodhojnë fusha alternative magnetike dhe forca e rrezatimit është në varshmëri të rrezatimit diellor.

Zakonisht invertorët ndërtohen në shtëpiza metali, të cilat ofrojnë një barrier të konsiderueshme të rrezatimit. Pasiqë, edhe ashtu vetëm fusha alternative magnetike të vogla krijohen dhe po ashtu nuk paraqet një vend me nevojën për të qëndruar gjatë afër, atëherë edhe nuk llogaritet si me ndikim mjedisor. Kabllot në mes Invertorit dhe stacionit të kyçjes në rrjet, llogariten si kabllot të rrymes së një shporeti elektrik apo ndonjë lavatriqeje.

Dergimi i rrymës elektrike në rrjet kalon përmes një transformatori, i cili transformon rrymen e një tensioni të ultë në atë të mesëm. Fushat maksimale të prodhuara nga këta transformator arrijnë pas pak metra vlerat e kufizuara. Në 10 m distancë nga këto transformator arrihen vlerat edhe më të vogla se ato të shkatuara nga pajisjet elektrike shtëpiake.

### **5. 2. 6. Efektet vizuale**

Edhe pse panelet diellore për dashamirë të natyrës mund të paraqesin një prishje të kullitetit estetik, megjithatë deri më tani nuk njihen konflikte të theksuara në aspektin e prishjes së balancit natyror. Për shumicën e banorëve, falë pozicionit të lokacionit dhe madhësisë së paneleve, këto panela do të jenë pak të ekspozuara ndaj tyre. Ato do të jenë të ekspozuara vetëm për ata të cilët kanë pamje nga distanca.

Sipas analizave të rezultateve të llogaritura tregon se niveli i zhurmës që lajmërohet në rrethinë si pasojë e funksionimit të paneleve diellore, është e

papërfillshme dhe shumë më e ulët së normat maksimale të lejuara për intervalet e punës gjatë ditës (55 dB) dhe natës (40 dB).

### **5. 2. 7. Ndikimet ne Faunë**

Gjatë fazës së shfrytëzimit të paneleve diellore, sipërfaqet në hapësirën ku do të ndërtohen panelet diellore, mund të shfrytëzohen për kullosa sepse panelet Diellore do të vendosen në shtylla dhe nuk pengojnë blegtorinë gjatë kullotjes .

Gjatë fazës së shfrytëzimit ndikimi i paneleve diellore në botën shtazore është relativisht i vogël për arsye se sipërfaqet do të jenë të lira dhe të mbjellura me barë përpos ku janë të vendosura shtyllat, prandaj në këto sipërfaqe të lira, mund të zhvillohet bota shtazore. Ndikime negative nga panelet diellore, mund të ketë në shpezët, mirëpo me kalimin e kohës edhe shpezët do t'i përshtatën punës së paneleve diellore. Ndikimi i paneleve diellore, ne shpezët mund të shikohet: si ndikim direkt rreziku nga ndeshja e tyre në panelet diellore dhe si ndikim indirekt nga ndikimet e zhurmës dhe ato vizuale, që mund të ndikoj ne ndërrimin e lokacionit. Në hapësirën e paneleve diellore ndikimi do të jetë shumë i vogël nëse përfshihen këto kritere, të cilat do t'u përmbahet Kompania. Kriteret janë :Lidhja e kablllove nëntokë është më i dobishëm sepse shpezët nuk mund të përdorin si vend pushim gjatë fluturimit, si në rastin nëse kabllot do të ishin të vendosura me shtylla dhe shpezët mund ta shfrytëzonin si vendpushim.

Ndikim tjetër në botën e shpezëve do të ishte nëse panelet diellore ndërtohen në vend shtegtimin e shpezëve. Mirëpo, sa i përket shpezëve shtegtar ato fluturojnë mbi lartësitë e paneleve diellore.

### **5. 3. Ndikimet në mjedis pas ndërprerjes së shfrytëzimit**

Ndikimet e mundshme pas ndërprerjes së shfrytëzimit (mbi 25 vjet) të paneleve diellore, veprimi i çmontimit dhe largimit të pjesëve të çmontuara është relativisht i thjesht dhe lokacioni mund të sanohet.

## **6.0. Marrja e Masave për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Ndikimeve**

Masat e mbrojtjes së mjedisit që duhet të zbatohen gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore kanë për qëllim zvogëlimin e ndikimeve në mjedis për



shkak të rritjes së qarkullimit, përdorimi i mekanizmave të rëndë ndërtimore, gërmimeve të dheut dhe aktivitete tjera gjatë ndërtimit.

Gjatë fazës së ndërtimit duhet të ndërmerren këto masa të mbrojtjes së mjedisit.

### **6.1. Ndërmarrja e masave gjatë fazës së ndërtimit**

Gjatë ekzekutimit të punëve gjatë fazës së ndërtimit të Parkut të Energjisë Diellore, dheu nevojitet të largohet nga shtresa sipërfaqësore dhe veçmas të deponohet dhe të mos ndotet dhe pas përfundimit të punimeve të mbulohen sipërfaqet e degraduara. Bartësi i projektit duhet të sigurojë që ekzekutimi i punimeve të bëhet me mekanizmat ndërtimore që teknikisht janë në rregull, duke iu përmbajtur dokumenteve projektuese dhe respektimi i rregullave të ndërtimit.

Të gjitha sipërfaqet që janë shfrytëzuar për nevojat e ndërtimit duhet të sanohen dhe të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Aktiviteti i zhvilluar gjatë ndërtimit duhet të ekzekutohet në atë mënyrë që të mos e pengojë qarkullimin normal të komunitetit.

Automjetet transportuese duhet t'i plotësojnë kushtet sipas rregullores mbi kontrollin teknik.

#### **6.1.1. Ndërmarrja e masave për mbrojtje nga zhurma dhe gazërat**

Kryesi i punëve duhet të sigurojë që ndërtimi i paneleve diellore të bëhet me pajisje ndërtimore që janë teknikisht në rregull, që do të thotë se emisioni i zhurmës dhe lirimi gazërave të jetë në kufijtë e lejueshmërisë sipas ligjit.

Punët që bëhen nën zhurmë të lartë duhet të zhvillohen gjatë ditës pos në raste specifike kur kërkon teknologjia e punës mund të zhvillohen edhe gjatë natës.

#### **6.1.2. Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e tokës dhe ujërave**

Rezervarët ose fuqitë ku mbahen karburantet për automjetet dhe mekanizmat ndërtimore punues duhet të jenë të sigurtë ose të vendosen në mure të dyfishta ashtu që në asnjë mënyrë të mos vie deri derdhja e derivateve në tokë.

Servisimi i mekanizmave nuk guxon të bëhet në punishte apo në sipërfaqet shërbyese por duhet të bëhet në serviset e autorizuara për mekanizma.

Vaji i makinave të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë.

Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në vendpunishte për shkak të avarive në makinat e punës, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet.

Në punishte duhet të ketë material (pluhur druri) që në raste të derdhjeve të vajrave të ndryshme të intervenohet me njëherë për pastrim.

Mbeturinat e lëngta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të pajimeve duhet të deponohen në enë të posaçme të cilat mbeturina do t'i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

Depoja ku deponohen derivatet, vajrat dhe lubrifikantet e ndryshme si dhe vajrat e përdoruar të thurret me mur statik si dhe platoja ( dyshemeja) të betonohet. Të gjitha mbeturinat e krijuara duhet të mblidhen dhe të vendosen jashtë punishtes ku vendosen panelet diellore kurse me ato mbeturina të veprohet sipas rregullave të ligjit të mbeturinave Nr. 08/L-071.

Makinat ngarkuese dhe transportuese pas kryerjes se orarit të punës të parkohen në vendin e caktuar enkas për to. Për nevojat e personelit punues të vendosen kabinat e WC lëvizëse

### **6.1.3. Masat e përkujdesjes për materialin tepricë**

Materiali nga gërmimi i dheut që i plotëson kushtet për përgatitjen e sipërfaqeve shërbyese dhe rrugëve kaluese duhet të shfrytëzohet për ato qëllime. Materiali i gërmuar në vendin e gërmimit duhet të imtësohet e pastaj të transportohet në vendin ku do të shfrytëzohet.

Materiali tepricë i cili duhet të largohet nga lokacioni, duhet që në marrëveshje me komunitetin lokal të transportohet në lokacionet ku kryen ndonjë shërbim apo vendoset diku ku nuk degradon mjedisin.

## **6.2. Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë operimit**

Edhe pse ndikimet në mjedis vlerësohen të jenë minimale gjatë fazës së operimit, megjithatë shtrohet nevoja e disa nga masave të cilat evitojnë ndotjet potenciale apo minimizojnë ato.

### **6.2.1. Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e llojeve bimore dhe shtazore**

Ekzekutimi i punëve instaluese duhet të bëhet në atë mënyrë që pamja natyrore ekzistuese e lokacionit përreth të mos ndryshojë. Të bahet rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara dhe sipërfaqet e rehabilituara të mbillen me barë duke ju përshtatur mjedisit rrethues.

Pas fazës së ndërtimit do të ketë rrethoja me tela në punishte ashtu që të gjitha rrugët e migracionit të faunës nëpër lokacionin e Parkut të Energjisë Diellore do të jenë të lira. Ndërtimi i Parkut të Energjisë Diellore në hapsirat përreth nuk ka ndikim në florë dhe faunë sepse kemi të bëjmë me një energji të pastërt me zero emisione operationale dhe me ndikime minimale në mjedis, pra panelet diellore sjellin vetëm dobi për mjedisin. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233 në territorin ku planifikohet të ndërtohet Parku i Energjisë Diellore nuk kemi ndonjë vlerë natyrore që duhet të i kushtohet rëndësi gjatë fazës së ndërtimit.

### **6.2.2. Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e tokës dhe ujit**

Me rastin e pastrimit eventual të paneleve diellore, edhe pse supozohet se ato mund të jenë të rralla në rastet kur mungojnë të reshurat e shiut, duhet pasur kujdes që të shfrytëzohet vetëm uji pa ndonjë agjentë shtesë.

Nëse vjen deri te nevoja për servisimin e paneleve diellore atëherë ajo duhet të bëhet në sipërfaqet shërbyese për servisim.

Të gjitha mbeturinat e krijuara gjatë servisimit, pas përfundimit të punëve duhet të largohen, mbeturinat nuk guxojnë të mbesin në lokacionin e paneleve solare. Mbeturinat duhet të barten në lokacionet e parapara apo të lejuara në nivel komune apo në deponinë regjionale.

### **6.2.3. Ndërmarrja e masave për menaxhimin e mbeturinave**

Disa nga masat me rëndësi janë ato që lidhen me menaxhimin e mbeturinave eventuale. Investitori obligohet që mbetjet dhe pjesët e ndërruara të kthehen në riciklim.

#### **6.2.4. Ndërmarrja e masave për zbutjen e ndikimit vizual**

Për zvogëlimin e ndikimit vizual, investitori do të këshillohet për mbëltimin e drunjve në hapsirat përreth fushës së paneleve diellore. Kjo do të ndikonte pozitivisht në pengimin e ekspozimit për banorët e fshatrave.

#### **6.2.5. Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e zogjëve**

Edhe pse panelet diellore nuk do të kenë ndikime negative në zogjë sepse nuk do të ndërtohen në lartësi të mëdha dhe zogjtë do të lëvizin mbi panelet diellore mirëpo, prapsepapë urdhërohet Investitori që të respekton Direktivën për ruajtjen e zogjëve të egër 79/409/EC të datës 2 Prill 1979, Qëllimi i kësaj Direktive është që të sigurohet mbrojtje, menaxhim, dhe kontrollimin e zogjëve të egër dhe foleve dhe vendbanimeve të tyre Brenda Unionit Evropian. Kjo shërben si sigurim që të gjithë zogjtë e egër të pranojnë mbrojtje të nevojshme nga asgjësimi i tyre; gjithashtu vendbanimet e tyre të mbrohen, në veçanti të sigurohet për ata të cenuar dhe migrim të zogjëve; Gjithashtu, ndalimin e mjeteve në shkallë të lartë dhe atyre jo-selektive si dhe eksploatimin komercial të shumicës së zogjëve duhet të parandalohet. Lidhur me Traktatin, Kosova duhet të implementojë Nenin 4 (2) kur traktati hynë në fuqi. Ky nen paraqet si në vijim:

#### **Neni 4**

1. Speciet të përmendura në Shtojcën I do të jene subjekt i masave për ruajtjen speciale lidhur me mjedisin në mënyrë që të sigurohet për të mbijetuarit e tyre dhe reproduksionin në pjesët e tyre të shpërndarjes

Lidhur me këtë, duhet të merret parasysh:

- (a) speciet në rrezik nga zhdukja;
- (b) speciet të cenuar nga ndryshimet specifike në vendbanimet e tyre
- (c) speciet konsiderohen të rrallë për shkak të numrit të vogël të popullatës apo shpërndarjes lokale ristriktë;
- (d) species tjera kërkojnë vëmendje të posaçme për arsye të natyrës specifike të mjedisit apo vendbanimit të tyre.

Rezultatet e monitorimit nga fillimi i funksionimit të paneleve diellore na paraqesin një bazë themelore se a do të ketë nevojë të ndërmerren masa shtesë për mbrojtje në formë të instalimit të ndonjë pajisje të caktuar .

### **6.3. Masat e mbrojtjes së mjedisit pas ndërprerjes së projektit**

Sipas prospekteve nga shumë prodhues të paneleve Diellore kemi se shfrytëzimi i tyre mund të bëhet mbi 25 vite. Projekti është planifikuar të prodhojë për një afat kohor prej 25 viteve. Kjo nënkupton se të gjitha pajisjet e përdorura në këtë projekt kanë garancion të prodhimit 25 vite. Pas skadimit të afatit të gjitha materialet e përdorura janë të riciklueshme dhe kanë certifikatat TUV të riciklimit. Nga prodhimi 25 vjeçar ndahen 1% e profitit për pastrimin e vendit dhe riciklimin e materialeve. Pjesa më e madhe e materialeve janë nga Alumini, Qelqi dhe Hekuri i zinguar. Të gjitha këto materiale janë të riciklueshme.

Pas kësaj periudhe varet nga investitori se a do të vazhdohet me prodhimin e energjisë diellore duke bërë zëvendësimin me panele diellore të rinj apo panelet Diellore do të largohen. Në rastet kur bëhet largimi i paneleve diellore, veprimi i çmontimit dhe largimit të pjesëve të çmontuara është relativisht i thjeshtë dhe lokacioni mund të sanohet. Në ato raste kur duhet të largohen panelet diellore nevojitet të përgatitet raporti për mbrojtjen e mjedisit përmes të cilit qartë do të definohet ndikimi në mjedis dhe përshkruhen masat e nevojshme që duhet të ndermirrën. Largimi i paneleve diellore duhet të bëhet në mënyrë që të çmontohen të gjitha pajisjet mekanike dhe elektrike dhe varësisht prej gjendjes së tyre të dërgohen për riciklim në qendrat e licencuara për riciklim të metaleve apo të ripërdoren, kabllot elektrike do të nxirren nga toka dhe pastaj do të bahet rrafshimi i hapësirave të degraduara dhe të bëhet mbjellja me bar apo kulturë tjetër në varshmëri nga gjendja në terren. Pjesët nga demontimi i paneleve diellore të trajtohen, deponohen dhe transportohen vetëm nga operatorët dhe personat e licencuar. Pas largimit të paneleve diellore sipërfaqet e degraduara duhet të rrafshohen dhe mbulohen me një shtresë të dheut dhe të bahet mbjellja me bar e këtyre hapësirave dhe hapësirave tjera të degraduara. Rikultivimi i tokave duhet të bëhet duke ju përshtatur gjendjes së mjedisit rrethues. Gjatë largimit të paneleve diellore duhet të merrën të gjitha masat për mbrojtjen nga ndikimet negative në mjedis të cilat janë marrë gjatë ndërtimit të paneleve diellore.

## **7.0 Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit**

### ***7.1 Plani i Menaxhimit Mjedisor (PMM)***

Plan i Menaxhimit Mjedisor synon të sigurojë zbatimin e masave zbutëse dhe monitoruese të nevojshme për të zvogëluar dhe kontrolluar ndikimet e ndryshme mjedisore dhe sociale të lidhura me zbatimin e projektit të propozuar.

Objektivat kryesore të PMM janë përmbledhur më poshtë:

- Minimizimi i çdo ndikimi negativ mjedisor, social dhe shëndetësor që rezulton nga aktivitetet e projektit;
- Kryerja e të gjitha aktiviteteve të projektit në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës, kushtet e lejeve dhe praktikrat e mira.
- Sigurimi që të gjitha shqetësimet e palëve të interesuara të adresohen.

Në përgjithësi, ky PMM dokumenton çështjet kryesore të mbrojtjes së mjedisit dhe çështjeve sociale, veprimet që duhen ndërmarrë për t'i adresuar ato në mënyrë adekuate, si dhe orarin dhe personin/njësine përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin.

Me zbatimin e Planit të Menaxhimit Mjedisor mbrojtja maksimale ndaj mjedisit dhe njerëzve do të sigurohet në nivel të kënaqshëm.

Në tabelën e më poshtme do pasqyrojme PMM.

## PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

### Gjatë fazës së ndërtimit

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
<b>Cilësia e ajrit</b>	<p>Emetimi i ndotësve për shkak të djegies dhe emetimeve të shkarkimit të krijuara nga pajisjet e ndërtimit, gjeneratorët, automjetet dhe trafiku i projektit</p> <p>Gjenerimi i pluhurit gjatë punimeve të ndërtimit dhe lëvizjes së automjeteve.</p>	Përkeqësimi i cilësisë së ajrit të ambientit për shkak të emetimeve të ndotësve	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Zhvillimi i PMMN (Plani i Menaxhimit të Mjedisit të Ndërtimit) i cili do të specifikojë masat e duhura për menaxhimin e pastrimit, gjermimit dhe aktiviteteve të ndërtimit për të minimizuar gjenerimin e pluhurit, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Aktiviteti ndërtimor do të vendoset larg zonave të ndjeshme të tokës dhe receptorëve aty ku është e mundur, dhe do të sigurojë që aktivitetet të kryhen kur drejtimi i erës do të drejtojë materialin larg këtyre receptorëve;</li> <li>▪ Zonat e hapura të gjermimeve do të minimizohen.</li> <li>▪ Deponimi i dheut dhe materialit prej dheu do të minimizohet nga koordinimi i duhur i punimeve tokësore dhe aktiviteteve të gjermimit (gjermimi, selektimi, ngjeshja, etj.)</li> </ul> </li> <li>➤ Ulja e shpejtësisë në rrugët e pashtuara dhe marrja e masave të tjera sipas nevojës për të zvogëluar emetimet nëse ndodh emetimi intensiv i pluhurit, derisa të vendosen spërkatjet e ujit ose masat e tjera zbutëse.</li> <li>➤ Spërkatja e rregullte sheshit të ndërtimit dhe rrugëve hyrëse gjatë sezonit të thatë do të zbatohet si një masë për të shtypur pluhurin Shpejtësia e automjeteve do të kufizohet në vendet e ndërtimit dhe rrugët hyrëse në 20 km/orë. Mjetet që shpërndajnë materiale do të mbulohen.</li> <li>➤ Mbyllja dhe mbulimi i stoqeve të materialeve me pluhur gjatë ruajtjes në depo;</li> <li>➤ Të gjitha makineritë dhe pajisjet e ndërtimit do të mirëmbahen në gjendje të mirë pune dhe nuk do të lihen në punë kur nuk janë në përdorim.</li> <li>➤ Përdorimi i lëndëve djegëse të standardizuara për makineri dhe automjete transporti;</li> <li>➤ Shmangia e aktiviteteve që prodhojnë pluhur gjatë periudhave të erërave të forta.</li> <li>➤ Asnjë djegie e asnjë materiali kudo në kantieret e ndërtimit</li> <li>➤ Punëtorët duhet të mbrohen nga ndikimet e pluhurit dhe emetimeve, për shembull përmes kërkesave për sigurimin e maskave të pluhurit kur punoni pranë aktiviteteve që krijojnë pluhur.</li> </ul>	<p>Kontraktori</p> <p>Mbikqyrësi</p> <p>Stafi i komunes</p>
<b>Dheu(toka)</b>	Gjermimet për themelet, mbushja	Prishja e strukturës së shtresës së tokës	➤ Aktivitetet e ndërtimit do të kufizohen brenda kufirit të impianteve PV të propozuara dhe nuk do të ndryshojnë përdorimin e tokës në zonat ngjitur;	Kontraktori

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
	dhe ndërtimi i rrugëve hyrëse nëse është e nevojshme.		<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Rrugët hyrëse tashmë ekzistuese do të përdoren sa më shumë që të jetë e mundur gjatë aktiviteteve të ndërtimit. Të gjitha makineritë e ndërtimit dhe automjetet e transportit do të përdorin rrugë hyrëse të miratuara;</li> <li>➤ Minimizimi i heqjes së shtresës së tokës dhe kufizimi vetëm në ato zona ku është e nevojshme;</li> <li>➤ Heqja dhe ruajtja e shtresës së sipërme të tokës pjellore, e ndjekur nga ri-kultivimi dhe restaurimi i tokës pas zbatimit të punimeve;</li> <li>➤ Depot do të mbulohen në mënyrë të përshtatshme për të zvogëluar humbjen e tokës si rezultat i erozionit të erës ose ujit;</li> <li>➤ Programimi i aktiviteteve (për aq sa është e mundur) për të shmangur ngjarjet ekstreme të motit siç janë reshjet e mëdha të shiut dhe erërat e forta;</li> <li>➤ Rekomandohet të rritet bari nën panelet diellore për të shmangur erozionin e tokës;</li> <li>➤ Për të kontrolluar erozionin e tokës, ujerat rrjedhëse sipërfaqesore duhet të mblidhet nga të gjitha zonat e punës dhe të orientohen në kanale kullimi për të kufizuar përqendrimin e prurjeve.</li> <li>➤ Kanalet e kullimit do të ndërtohen në përputhje me kushtet topografike të Zonës së Projektit nëse është e nevojshme;</li> <li>➤ Pas përfundimit të aktiviteteve ndërtimore, toka e përdorur për objekte të përkohshme do të restaurohet në masën e mundshme.</li> </ul>	Mbikqyrësi Stafi i komunës
	Derdhja ose rrjedhja e vajrave/lëndëve djegëse nga automjetet e ndërtimit dhe makineritë e tjera, ruajtja jo e duhur e vajrave/karburanteve të mbeturinave dhe kimikateve të tjera dhe menaxhimi i dobët i mbeturinave	Ndotja e tokave	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Automjetet dhe pajisjet e ndërtimit do të servisohen rregullisht. Servisimi dhe pastrimi i makinerive të ndërtimit dhe automjeteve transportuese nuk do të bëhet në vendin e ndërtimit</li> <li>➤ Karburanti, vajrat dhe vajrat e përdorur nuk duhet të mbahen në vendin e ndërtimit. Nëse është e nevojshme, ato duhet të ruhen në një mënyrë në të cilën ata nuk do të vijnë në kontakt me mjedisin (në fuçi dhe tanke të mbyllura, të vendosura në një kuti betoni të armuar me një hapësirë mbajtëse);</li> <li>➤ Magazinimi dhe përdorimi i karburanteve/vajrave dhe hidrokarbureve të tjera do të bëheshin në zona të caktuara me baza të forta (jo tokë) dhe të vendosura të paktën 50 m larg çdo rrjedhe uji; Zbatimi i praktikave të mira në përdorimin dhe ruajtjen e kimikateve dhe menaxhimin e mbeturinave përmes masave të përcaktuara në Projektin që do të zhvillohet për fazën e ndërtimit;</li> <li>➤ Çdo kimikat i derdhur do të mblidhet menjëherë dhe do të asgjahohet në përputhje me Planin e Parandalimit <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontraktuesi do të përgatisë udhëzime dhe procedura për veprimet e menjëhershme të pastrimit pas çdo derdhje të naftës, karburantit ose kimikateve. Derdhjet e pastruara të naftës, karburantit</li> </ul> </li> </ul>	



Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
			<p>ose kimikateve do të trajtohen nga kompanitë e specializua</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çdo protokoll ngarkimi dhe shkarkimi duhet të përgatitet përkatësisht për naftë, vaj dhe vaj të përdorur;</li> <li>➤ Kontraktuesi do të zbatojë një program trajnimi për të njohur stafin me procedurat dhe praktikat e urgjencës që lidhen me ngjarjet e kontaminimit</li> <li>➤ Kontraktuesi duhet të sigurojë (te ketë në dispozicion) një enë të posaqme për aktivitetet e pastrimit emergjent në rast të derdhjes së kimikateve/vajit;</li> <li>➤ Për nevojat sanitare të punëtorëve do të përdoren tualete të lëvizshme dhe do të mirëmbahen rregullisht nga një kompani e autorizuar;</li> </ul>	
<b>Peizazhi dhe aspektet vizuale</b>	Magazinimi i përkohshëm i materialit, makinerive, rrugëve hyrëse të përkohshme, ndërtimi i impiantit FV	Ndryshim i përkohshëm në peizazh dhe ndërhyrje vizuale	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mirëmbajtja e kantierit në një gjendje të rregullt.</li> <li>➤ Zbatimi i menaxhimit të mirë të ndërtimit dhe pastrimit për të kontrolluar aktivitetet dhe për të ruajtur zona të pastra pune (kjo do të arrihet përmes zhvillimit të Projektit);</li> <li>➤ Sigurimi i konsultimeve të vazhdueshme me komunitetet lokale gjatë gjithë periudhës së ndërtimit.</li> </ul>	Kontraktori Mbikqyrësi
<b>Zhurma</b>	Funksionimi me pajisje, Aktiviteti i heqjes së shtresës së dheut, Lëvizja e automjeteve të ndërtimit, Ndërtimi i rrugës së hyrjes	Telashi i zhurmës	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Planifikimi i aktiviteteve të punës për të minimizuar zhurmën e emetuar (përsa i përket kohës dhe intensitetit);</li> <li>➤ Kufizimi i aktiviteteve të ndërtimit në orët e ditës (ora 8 e mëngjesit - 5 pasdite);</li> <li>➤ Mirëmbajtja e pajisjeve dhe monitorimi i emetimeve të zhurmës, të menaxhuara përmes zhvillimit të projektit</li> <li>➤ Plani për mbrojtjen e punëtorëve;</li> <li>➤ Kontraktuesi do të kufizojë boshatisjen e motorëve kur nuk janë në përdorim për të zvogëluar kontributin e tij në emetimet e zhurmës;</li> <li>➤ Kufizimi i shpejtësisë së automjeteve në rrugë të pashtuara për transportin e materialeve.</li> <li>➤ Informimi i popullatës vendase për aktivitetet e planifikuara në kantierin e ndërtimit</li> </ul>	Kontraktori Mbikqyrësi Stafi i komunes
<b>Trafiku</b>	Krijimi i trafikut nga aktivitetet e ndërtimit	Komuniteti dhe siguria e fuqisë punëtore dhe qarkullimi lokal i trafikut	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Zhvillimi i Planit të Menaxhimit të Trafikut në Ndërtim (PNMT);</li> <li>➤ Sinjalizimi i duhur dhe shenjat e sigurisë në komunikacion të vendosen në rrugët hyrëse;</li> <li>➤ Trajnimi i shoferëve në sigurinë rrugore dhe kodin e mirësjelljes;</li> </ul>	Kontraktori Mbikqyrësi Stafi i komunes

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
			<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Shqyrtimi i punës graduale për të siguruar ruajtjen e aksesit lokal;</li> <li>➤ Komunikoni rrugët e transportit dhe orarin e parashikuar për komunitetet;</li> <li>➤ Vendorsja e kufijve të shpejtë;</li> <li>➤ Mirëmbajtja e automjeteve dhe pajisjeve të ndërtimit dhe përfshirja e detajeve mbi inspektimet;</li> <li>➤ Monitorimi dhe vlerësimi i trafikut dhe incidenteve të transportit;</li> <li>➤ Zbatimi i përmirësimeve të rrugëve aty ku është e nevojshme (riparoni ose rivendosni rrjetin rrugor nëse dëmtohen nga automjetet e Projektit);</li> <li>➤ Sigurimi që të gjithë kamionët dhe automjetet të operohen nga operatorë të licencuar;</li> <li>➤ Prania e flamurit në hyrje dhe dalje të vendit të projektit në mënyrë që të kontrollojë lëvizjen e automjeteve dhe kamionëve</li> </ul>	
<b>Menaxhimi i mbeturinave</b>	<p>Aktivitetet e përgjithshme të ndërtimit,</p> <p>Mbeturinat e krijuara nga fuqia punëtore,</p>	<p>Ndikimi vizual i mbeturinave. Ndikimi në tokë dhe ujërat nëntokësore nga menaxhimi / ruajtja e dobët e mbeturinave sanitare dhe të rrezikshme.</p> <p>Vëllimet e panevojshme të dërguara në deponi përmes mungesës së ripërdorimit dhe riciklimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Identifikimi i llojeve të ndryshme të mbeturinave në vendin e ndërtimit (tokë, letër dhe dollap; paketime plastike, dru, ushqim, etj.);</li> <li>➤ Klasifikimi i mbeturinave sipas Listës së Mbetjeve;</li> <li>➤ Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve për fazën e ndërtimit;</li> <li>➤ Kontraktimi me kompanitë e autorizuara për grumbullimin dhe menaxhimin e mëtejshëm të llojeve të ndryshme të mbeturinave;</li> <li>➤ Kontraktuesi do të përzgjedhë dhe do të hedhë përkohësisht llojet e ndryshme të mbeturinave, të tilla si materiale ndërtimi të riciklueshme jo të rrezikshme, plastikë, letër, për të lehtësuar asgjësimin e duhur;</li> <li>➤ Mbeturinat e prodhuara nga punëtorët (mbeturina komunale)</li> <li>➤ Një pjesë e mbeturinave të ndërtimit (p.sh. skrap metali) që do të ripërdoren. Pjesa e mbeturinave të ndërtimit e cila nuk mund të ripërdoret, për t'u deponuar;</li> <li>➤ Kontraktuesi do të sigurojë një zonë të veçantë të ruajtjes së përkohshme për materialet e rrezikshme (duhet të etiketohet me identifikimin e duhur të vetive të tij të rrezikshme në përputhje me dispozitat e Fletëve të Dhënave të Sigurisë së Materialeve.</li> <li>➤ Mbeturinat e rrezikshme duhet të mblidhen veçmas dhe grumbulluesi dhe transportuesi i autorizuar duhet të nënkontraktohet për transportin dhe përfundimisht hedhjen e mbeturinave të rrezikshme;</li> <li>➤ Nafta e mbetur e gjeneruar nga gjeneratorët dhe makineritë e ndërtimit dhe automjetet transportuese</li> </ul>	<p>Kontraktori</p> <p>Mbikqyrësi</p> <p>Stafi i komunes</p>

Parametri	Çështjet nga Aktivitetet e Projektit	Ndikimet e mundshme	Masat zbutëse të propozuara	Përgjegjësia
